



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 227 Prot.

Tiranë, më 27.06 2019

VENDIM Nr. 170 datë 25.06.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për saktësim të vendimit të KKA Nr. 141 për *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës" 2019*, drejtuar nga Prof.Asc. Eduard Shehi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e sipërpërmendur për *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës" 2019*, drejtuar nga Prof.Asc. Eduard Shehi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, duke saktësuar veprimtarinë sipas pikave të mëposhtme:
 - Gërmim në oborrin e shkollës "Jusuf Puka" i cili synon të identifikojë tiparet që kanë karakterizuar zgjerimin apo ngushtimin e qytetit antik drejt lindjes. Pas përfundimit të gërmimeve territori do të rikthehet në gjendjen e paragërmimit.
 - Gërmim në mes të kullave D dhe E.
 - Gërmim në një oborr të një banese, pronë e kishës katolike i cili synon të identifikojë evoluimin e qytetit antik nga origjina deri në antikitetin e vonë. Kjo sipërfaqe gjendet praktikisht në qendër të qytetit dhe e ofron një mundësi të tillë. Gërmimi në këtë zonë është në varësi të marrëveshjes me pronarin e tokës. Pas përfundimit të gërmimeve territori do të rikthehet në gjendjen e paragërmimit.
 - Ndërhyrje në strukturat romake në lindje të Forum-Macellum, vazhdimi i sondazheve të vitit 2018. Synohet zgjerimi horizontal i territorit të gërmuar për të arritur në nivelet e periudhës arkaike. I gjithë territori do të rikthehet në gjendjen e mëparshme si dhe do të lihet i pastruar dhe i vizitueshëm.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

